



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 548/4 prot.

Tiranë, më 29.09.2020

**V E N D I M**

Nr.101, datë 29.09.2020

**MBI PËRFUNDIMIN E VERIFIKIMIT TË LIGJSHMËRISË SË VEPRIMIT ADMINISTRATIV TË LËVIZJES NË DETYRË, TË NËPUNËSES SË BASHKISË SARANDË, \*\*\*\*\*.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dokumentar të mbledhur për verifikimin e informacionit që përmbante kërkesa e nëpunëses së Bashkisë Sarandë, \*\*\*\*\*,

**VËREJ :**

Punonjësja \*\*\*\*\* është konfirmuar “nëpunës civil” në pozicionin e punës “Specialist arkiv-protokolli”, në Drejtorinë e Personelit dhe Burimeve Njerëzore, pranë Bashkisë Sarandë, nëpërmjet aktit nr. 1313 prot., datë 15.05.2018 “Akti i Deklarimit të Statusit të Punësimit”.

Punonjësja në fjalë ka vazhduar të kryejë këtë detyrë deri në momentin kur, me aktin tjetër nr. 46/1, datë 29.05.2020, të Kryetarit të Bashkisë Sarandë, është urdhëruar lirimi i saj nga detyra që kryente si “Specialist arkiv-protokolli” dhe emërimi në pozicionin “Specialist sporteli të zyrës me një ndalesë”, me arsyetimin se institucioni ka kaluar në proces ristrukturimi.

Përmbajtja e pretendimeve për paligjshmëri, të parashtruara nga nëpunësja \*\*\*\*\* konsistojnë në faktin e kalimit të saj nga një pozicion pune pjesë e shërbimit civil, në një pozicion pune jashtë shërbimit civil, me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, pa respektuar procedurën e parashikuar në rastet e transferimit të përkohshëm apo të përhershëm të nëpunësit civil dhe në arsyetimin prej titullarit të institucionit se, pozicioni ku është transferuar nëpunësja, është pjesë e shërbimit civil dhe se në këtë rast jemi para një transferimi të përkohshëm, deri në plotësimin e pozicionit me konkurrim.

Për sqarimin e kësaj çështje, hetimi administrativ u bazua tek praktika shkresore e dërguar nga Bashkia Sarandë, protokolluar me nr. 548/2, datë 24.07.2020 “*Informacion në lidhje me nëpunësen \*\*\*\*\**”, si dhe dokumentacioni i bashkëlidhur ankesës së paraqitur nga nëpunësja \*\*\*\*\*.

Duke analizuar ligjërisht faktet e parashtruara më sipër, arrijmë në përfundimin se akti nr.46/1, datë 29.05.2020, i Kryetarit të Bashkisë Sarandë, është një akt i kundraligjshëm, për arsyet e renditura më poshtë:

Së pari, akti i lirimt të nëpunëses nga detyra e mëparshme “*Specialist arkiv-protokolli*”, në asnjë moment nuk i referohet legjislacionit të shërbimit civil apo terminologjisë së tij. Akti administrativ nr. 46/1, datë 29.05.2020, i Kryetarit të Bashkisë Sarandë, është bazuar në disa dispozita të përgjithshme të ligjit nr. 139/2015 “*Për vetqeverisjen Vendore*”; të ligjit “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”; Vendimit nr. 43, datë 23.12.2019 “*Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelin e pagave për vitin 2020 të bashkisë dhe institucioneve në varësi*”, si dhe urdhrin të Kryetarit të bashkisë nr. 13, datë 27.02.2020 “*Për miratimin e strukturës së detajuar të Bashkisë Sarandë dhe institucioneve në varësi*”.

Në përgjigjen sqaruese të institucionit, dërguar nëpërmjet shkresës së tyre nr. 2551/1, datë 22.07.2020, pretendohet që në këtë rast kemi të bëjmë me një transferim të përkohshëm të nëpunëses, por, nga përmbajtja e aktit administrativ nr. 46/1, datë 29.05.2020, rezulton që ndaj nëpunëses është vendosur lirimi nga shërbimi civil, duke përdorur togfjalëshin që punonjësja “*lirohet nga kjo detyrë...*” dhe urdhërohet data e dorëzimit të detyrës, si dhe fillimi i marrëdhënies së re të punës, në pikën e shërbimit me një ndalesë. Nisur nga përmbajtja e neneve 63 dhe 66, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, lirimi nga shërbimi civil është përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.

Në rastin konkret nuk kemi të vërtetuar asnjë prej rasteve të parashikuara nga dispozitat e sipërpërmendura për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil. Po kështu, në rastin konkret nuk është respektuar procedura që ligji përcakton rast pas rasti për lirimin nga shërbimi civil, si një nga mënyrat e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, por kemi të bëjmë vetëm me një akt të drejtuesit të bashkisë për lirimin e nëpunëses nga detyra.

Së dyti, akti i Kryetarit të Bashkisë Sarandë është nxjerrë në kapërcim të kompetencave. Në bazë të neneve 65 e 66, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, organi kompetent që ka atributin të përcaktojë nëse jemi para një rasti të lirimt nga shërbimi civil dhe të deklarojë lirimin, si mënyrë e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil (*sipas pikës 2, të nenit 65 dhe pikës 4, të nenit 66, të ligjit në fjalë*), është njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën.

Edhe sikur të pranohet se jemi përpara një transferimi të përkohshëm, siç pretendohet nga ana e insitucionit, në bazë të pikës 2/a, pikës 4 dhe pikës 5, të Kreut I, të Vendimit nr. 125 datë 17.02.2016 “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht, vetëm në kushtet që ka përcaktuar pika 1/a, e nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, transferim i cili, gjithashtu, duhet të

miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila ka detyrimin të verifikojë ligjshmërinë e tij dhe respektimin e kushteve të kërkuara nga legjislati.

Nëse miratimi i njësies përgjegjëse mungon, do të thotë se kemi të bëjmë me një akt të dalë në kundërshtim me ligjin dhe në kapërcim të kompetencave, gjë e cila në bazë të pikës a/i), të nenit 108, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, e bën aktin absolutisht të pavlefshëm dhe në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit në fjalë nuk mund/duhet të sjellë asnjë pasojë juridike.

Së treti, urdhri nr. 46/1, datë 29.05.2020 i Kryetarit të Bashkisë Sarandë, përbën një akt që e nxjerr padrejtësisht nëpunësen \*\*\*\*\* nga shërbimi civil. Kjo, për shkak se pikat e shërbimit me një ndalesë, në bazë të pikës “dh”, të nenit 4, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, janë “njësi publike direkte shërbimi”, të cilat në bazë të pikës “ë”, të nenit 2, të ligjit në fjalë, nuk përfshihen në fushën e shërbimit civil. Ky përcaktim është bërë nga ligjvënësi dhe nuk lidhet me mënyrën si e perceptojnë organizmat e ndryshme shtetërore, gjatë zbatimit në praktikë të ligjit. Në këtë vështrim, pretendimi se nëpunësja \*\*\*\*\* është transferuar në një pozicion tjetër të shërbimit civil, nuk mund të pranohet. Ky fakt, në bazë të pikës “d”, të nenit 109, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, përbën një moment tjetër paligjshmërie të aktit në fjalë.

Nisur nga gjithë sa më sipër, në bazë të nenit 111, po të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, organi publik ka detyrimin ta konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të aktit të mësipërm dhe duke vepruar kryesisht, në bazë të nenit 113, pika 1, e ligjit në fjalë, duhet të anulojë me një akt të ri me shkrim, aktin nr. 46/1, datë 29.05.2020 dhe të marrë masat për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, duke e kthyer menjëherë, nëpunësen \*\*\*\*\* në pozicionin e saj të punës “Specialist arkiv-protokolli”.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; nenin 90, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 16, pika 8 dhe nenin 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Të kërkoj nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Sarandë që, për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, të organizojë dhe ndjekë procesin, nëpërmjet të cilit titullari i institucionit në fjalë, të anulojë aktin nr. 46/1 dt. 29.05.2020, duke e kthyer nëpunësen \*\*\*\*\* në pozicionin e saj të punës “Specialist arkiv-protokolli”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, në Bashkinë Sarandë.

2. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat 15 ditë, nga marrja dijani për këtë vendim.
3. Me kalimin e këtij afati, institucioni është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e nëpunësit civil, që nuk ka kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin e rivendosjes së gjendjes së ligjshmërisë, duke përdorur mjetet ligjore, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
5. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Sarandë dhe nëpunësja \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**